

RELACION

Mbi

“Hartimin dhe miratimin e Buxhetit të Bashkisë Maliq për vitin 2020“

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“ neni 54 “Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak“ (gërma dh), Ligjit nr.9936,datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë“ neni 32 “Përgatitja dhe miratimi i buxheteve vendore“, Ligji 9920,dt.19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë“ i ndryshuar, Ligjit Nr.68,datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore“ ,VKM nr.165, dt.02.03.2016 “Për grupimin e Njësive të Qeverisjes Vendore për efekt page , dhe caktimin e kufijve të pagave të funksioneve të zgjedhur e të emeruar,të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Njësive të Qeverisjes Vendore“ i ndryshuar , Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 7/1,datë 28.02.2014 “Për përgatitjen e buxhetit vendor“ , shkresës së Ministrisë të Financave me nr.20458 prot ,date 11.11.2019 “Dërgohet për njoftim transferta e pakushtëzuar e përgjithëshme dhe sektoriale , për vitin 2020“ i paraqes Këshillit të Bashkisë për miratim “Buxhetin e Bashkisë Maliq për vitin 2020“.

Buxheti i Bashkisë Maliq për vitin 2020 synon:

1. Një sistem të financave të Bashkisë Maliq sa më transparent, një përgjegjshmëri maksimale e në efikasitet të plotë të menaxhimit dhe përdorimin e burimeve publike nga të gjitha aktorët që meren me to;
2. Qëndrueshmëri të financave duke mos krijuar borxhe në të ardhurat vendore;
3. Forcim të disiplinës financiare nëpërmjet zbatimit dhe kontrollit të të gjitha akteve ligjore në fuqi;
4. Përmirësim në raportim dhe monitorim të performancës financiare ;
5. Rritja e transparencës në mbledhjen dhe përdorimin e fondeve publike ;
6. Evidentim të riskut dhe marrje masash në minimizimin e rasteve që e shkatëojnë atë;
7. Realizimin e një qeverisje efektive me nivel dhe sa më afër qytetarëve nëpërmjet :
 - Respektimit të të drejtave të komunitetit;
 - Ushtrimit të funksioneve në mënyrë sa më efektive;
 - Realizimi i shpenzimeve të domosdoshme dhe me standartet e kërkuara;
 - Nxitja e komunitetit për pjesëmarrje në vetqeverisje me takime direkte, konsulta informime e pjesëmarrje në vendimarrjet e Këshillit të Bashkisë për këtë qëllim ;
 - Kontroll në vazhdimësi të të gjithë veprimtarisë ekonomiko financiare të strukturave të bashkisë me qëllim përmirësimin e punës;

Objektivat strategjike të buxhetit përfshijnë:

Objektivi strategjik 1: Zhvillimi ekonomiko-social i të gjithë territorit të bashkisë (urban e rural) , me synim uljen e papunësisë, frenimin e largimit të fuqisë punëtore dhe intelektuale me synim final fuqizimin e konkurrueshmërisë rajonale të Bashkisë Maliq ;

Objektivi strategjik 2: Zhvillimi i mëtejshëm i infrastrukturës vendore dhe rajonale, për të përmirësuar aksesin në boshtet kryesore, duke përmirësuar shërbimet ndaj komunitetit dhe turizmin në zonat malore ;

Objektivi strategjik 3: Menaxhimi i qëndrueshëm mjedisor, duke rritur kapacitetet prodhuese të tokës bujqësore por jo vetëm, me ide kreative të specialistëve tanë tek përduruesit respektivë;

Objektivi strategjik 4: Mbështetja maksimale në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, sportit me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të këtyre fushave prioritare;

Objektiv strategjik 5. Mbështetje për zonën rurale veçanërisht në fushën e blektorisë e produkteve autoktone;

Objektivat të tjera për buxhetin e vitit 2020 do të jenë:

- a) Rritje të burimeve financiare në dispozicion të bashkisë nga buxheti i shtetit, të ardhurat e veta apo donacionet e ndryshme;
- b) Zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, social dhe territorial nëpërmjet shpërndarjes sa më të drejtë të transfertave buxhetore apo të ardhurave të veta;
- c) Ofrimin e sa më shumë shërbimeve për qytetarët me cilësi dhe në kohë;
- d) Përmirësim të infrastrukturës vendore nëpërmjet financimit nga buxheti i shtetit, donatorët dhe të ardhurat e vetë institucionit;
- e) Përmirësim i mëtejshëm i kushteve në institucionet arsimore;
- f) Minimizimin e informalitetit ;
- g) Miratim e vënie në jetë të Planit të Përgjithshëm Vendor në shërbim të komunitetit e biznesit;
- h) Mbështetje e prodhimit dhe produkteve të zonës nëpërmjet promovimit të tyre
- i) Promovim i vlerave arkeologjike e turistike të zonës sonë;
- j) Zhvillimi i agroturizmit
- k) Përmirësim të klimës së biznesit;
- l) Krijimi i partenriteteve kombëtare e ndërkombëtare;
- m) Zhvillimi i qëndrueshëm i zonave të urbanizuara ;
- n) Sigurimi i koezionit social nëpërmjet rritjes së performancës së institucioneve shëndetësore, arsimore e qendrave të zhvillimit të vazhdueshëm profesional;
- o) Dhënie mundësie dhe mbështetje e biznesit për të siguruar akses punësimi për njerzit e prekur nga varfëria dhe përjashtimi social;
- p) Mbrojtja dhe promovimi i burimeve natyrore e kulturore;
- q) Promovimi, rrjetëzimi dhe përmirësimi i monumenteve dhe vendeve arkeologjike;
- r) Rrjetëzimi i kulinarisë, eventeve, aktiviteteve kulturore deri në krijimin e destinacioneve me interes turistik;

Hapat e Ndjekur :

- Buxheti i vitit 2020 ndoqi të gjitha hapat e përcaktuara në ligj apo akte të tjera nënligjorë , u analizuan kostot e shërbimeve dhe investimeve sipas objektivave dhe programeve si dhe standarteve në shërbime të ndryshme.
- Në këtë proces morrën pjesë të gjitha institucionet , 7 Njësitë Administrative si dhe komunitetet përkatëse.

- U realizuan takime me banorët në qendër të Njësive Administrative, duke dhënë informacion për punët që kishim realizuar apo janë në realizim e sipër si dhe objektivat apo kërkesat e tyre për vitin tjetër.
- U realizuan takime me drejtuesit e institucioneve arsimore, përfaqësues të organizatave jo fitimprurëse (OJF), grupeve të interesit duke evidentuar të gjitha problematikat, sygjerimet e prioritetet.

Kalendari i veprimeve për menaxhimin buxhetor dhe hapat që duhet të ndiqeshin kanë qënë bazë e punës sonë.

Në këtë kuadër do synojmë objektivat tona nëpërmjet :

- Rritjes së transfertës së pakushtëzuar e specifike bazuar në mekanizma ligjorë e zbatim sa më korrekt të formulës së vendosur për këtë qëllim.
- Përmirësimin të paketës fiskale dhe eliminim në maksimum të informalitetit në territor;
- Rritjen e efikasitetit dhe cilësisë të shërbimeve publike, me administrim dhe qeverisje më të mirë ;
- Nxitje dhe zhvillim ekonomik vendor e mbështetje për bizneset ;
- Rritja e transparencës dhe llogaridhënies në raport me komunitetet dhe Këshillin e Bashkisë;
- Rritjen e disiplinës financiare e menaxhimin sa më të mirë të shpenzimeve administrative me qëllim ofrimin e sa më shumë shërbimeve dhe investimeve për komunitetin;
- Përtej qëllimit ekonomik, synojmë të krijojmë edhe një mjedis shoqëror sa më të shëndetshëm nga i cili të përfitojë i gjithë komuniteti, ku e mira e përbashkët të mbizotërojë;

Funksionet sektoriale përfshijnë:

1-Personelin mësimor dhe jo mësimor në arsimin parashkollor dhe personeli jo mësimor në arsimin parauniversitar;

2-Rrugët Rurale;

3-Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave ;

4-Ujitja dhe Kullimi;

5-Shërbimi për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi (MZSH)

Për të hartuar një buxhet sa më real dhe sa më pranë qytetarëve u ngritën grupet e punës më datë 20.03.2019 “Për përgatitjen e buxhetit afat mesëm 2020-2022 të Bashkisë Maliq” .

Buxheti si çdo vit në vetvete përmban të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet pavarësisht nga natyra dhe burimi i financimit. Buxheti është i balancuar (pa deficit), pra të ardhurat do të përballojnë të gjitha shpenzimet e planifikuara e më të domosdoshme ;

I-Planifikimi i të Ardhurave

Buxheti që po ju paraqesim për vitin 2020 ka në përbërje :

1. Transfertën e Pakushtëzuar është çelur **293,303 mijë lekë** ose **2.4 %** më shumë se viti 2019. Në vitin 2019 kjo transfertë ka qënë **286,579 mije lekë**.
2. Transferta Sektoriale për funksionet shtesë kap shumën **151,732 mijë lekë** me një shtesë 2783 mijë lekë. Në total në buxhetin e vitit 2020 kemi një rritje në shumën **9,507 mijë lekë**.

3. Të ardhurat nga buxheti i pavarur për vitin 2020 janë planifikuar në shumën **300.000 mijë lekë**, në të njëjtin nivel si në vitin 2019

Të ardhura të mbartura nga viti 2019 prej transfertës apo nga të ardhurat e veta nuk do të jenë pjesë e këtij buxheti, pasi buxheti i vitit 2019 mbyllet më 31 Dhjetor dhe shuma që do të rezultojë e pa përdorur mbas rakordimit në fund të vitit me Degën e Thesarit Korçë do të miratohet me buxhetin shtesë në fillim të vitit 2020;

Të ardhurat sipas burimeve të financimit për vitin 2020

Nr.	BURIMET E FINANCIMIT	Shuma në /lekë
I	Të ardhurat Grande + të Ardhurat e veta	593,303,000
1	Transferta e Pakushtëzuar 2020	293,303,000
2	Buxheti Pavarur 2020	300,000,000
3	Të mbartura nga 2019	0
II	Transferat Sektoriale 2020	151,732,000
1	Arsimin parashkollor-Personel mesimor	73,267,000
2	Arsim parashkollor-Staf mbeshtetes	3,764,000
3	Arsimin parauniversitar	10,018,000
4	Administrimi i pyjeve	5,278,000
5	Rrugët	8,645,000
6	Ujitja dhe kullimi	37,816,000
7	Mbrojtja nga zjarri	12,944,000
	TOTALI	745,035,000

Të ardhurat e buxhetit të pavarur janë përlllogaritur bazuar në Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi që kanë të bëjnë me taksat apo tari fat vendore.

Buxheti për vitin 2020 përbëhet nga këta komponentë :

A-PAGA + SIGURIME SHOQËRORE

Përlllogaritjen e fondit të pagave për administratën e bashkisë, njësive administrative, dhe strukturave sektoriale të tjera është kryer sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.165 datë 02.03.2016 “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore,për efekt page ,dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar,të nëpunësve civilë dhe punonjësve administrativë të njësive të vetqeverisjes vendore”, i ndryshuar si dhe vendimarrjeve të Këshillit të Bashkisë apo Kryetarit të Bashkisë bazuar në kompetencat që ju jep Ligji nr.139/2015 ‘Për vetëqeverisjen vendore’ neni 54/ç e 64/j

Programet buxhetore që po ju paraqesim kanë për qëllim :

- Menaxhimi sa më efektiv të burimeve njerëzore , rritja e aftësive funksionale dhe performancës të çdo punonjësi ;
- Përmirësim të aftësive drejtuese dhe niveleve të tjera të vendimarrjes ;
- Ofrim të shërbimeve të plota, cilësore dhe në një kohë të shkurtër për biznesin dhe për qytetarët ;
- Krijimi i një administrate sa më profesionale,të aftë për të përballuar sfidat e përditshme ;
- Menaxhim me efikasitet të fondeve të vëna në dispozicion ;
- Administrim të sistemit tatimor në zbatim të akteve ligjore e nën ligjore në fuqi ;
- Transparencë, informim dhe asistencë ligjore për të gjithë tatimpaguesit ;
- Përmirësim të transportit urban nëpërmjet kontrolleve periodike ;
- Nxitje të qytetarëve, biznesit dhe palëve të interesuara për tu bërë pjesë e planifikimit të buxhetit ;
- Evidentim dhe përkrahje të familjeve realisht të varfëra ;
- Studime dhe projektme për ndërtimin apo rikonstruksionin e objekteve të reja ;
- Gjetjen e burimeve alternative për financimin e buxhetit dhe arritjen e objektivave ;

Produktet që duam të ofrojmë :

- Ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve në kohën më të shpejtë të mundshme me cilësi e transparencë pranë sporteleve të hollit me një ndalesë;
- Staf i trajnuar në vazhdimësi me institucione apo donatorë të specializuar ;
- Programe buxhetore afatmesëm dhe vjetorë për një administrim sa më të mirë ekonomik-financiar të bashkisë ;
- Ulje e informalitetit në fushën e biznesit ;
- Mbështetje me ndihmë sociale për gratë e fëmijëve në risk dhe zbutje të varfërisë për familjet në nevojë ;
- Lehtësi fiskale për shtresat në nevojë ;
- Ndjekje në vazhdimësi të emergjencave civile duke mbuluar detyrimet ligjore për të dëmtuarit ;
- Shpejtësinë në veprim të shërbimit të mbrojtjes kundra zjarrit dhe shpëtimit
- Mjedise arsimore por jo vetëm me standarte bashkëkohore ;

Tabela përmbledhëse e pagave + Sigurime Shoqërore

000/lekë

Nr	Programi	Kodi	Nr. Punonj.	Paga	Sigurime Shoq.+Shënd.	Paga + Sigurime
1	Aparati Administrativ	0 1110	153	93,010	15,533	108,543
2	Bujqësia	0 4220	11	6,739	1,125	7,864
3	Policia	0 3140	11	6,060	1,012	7,072
4	MZSH	0 3280	14	8,563	1,430	9,993
5	Kultura	0 8220	13	5,856	978	6,834
6	Mekanika	0 6260	21	10,246	1,711	11,957
7	Shërbimi Publik	0 6260	143	51,027	9,404	60,431
8	Rrugët	0 4520	23	7,772	1,511	9,283
9	Pyjet	0 4260	26	11,327	1,968	13,295
10	Ujitje -Kullim	0 4240	39	18,744	3,230	21,974
11	Arsimi 9-vjeçar	0 9120	94	66,000	11,031	77,031
12	Arsimi i mesëm	0 9230	16	8,592	1,426	10,018
	Shuma		564	293,936	50,359	344,295

B-SHPENZIME OPERATIVE

Shpenzimet operative përdoren për mbulimin e funksioneve dhe mirëmbajtjen e objekteve shkollore dhe institucioneve të tjera. Ato do të mbulohen nga të ardhurat e bashkisë . (Transferte +BP) si më poshtë vijon:

Nr.	Programi	Kodi	000/lekë
1	Aparati Administrativ	0 1110	32,636
2	Bujqësia	0 4220	232
3	Policia	0 3140	564
4	MZSH	0 3280	2,951
5	Kultura	0 8220	3,426
6	Mekanika	0 6260	10,591
7	Shërbimi Publik	0 6260	62,176
8	Rrugët	0 4520	2,616
9	Pyjet	0 4260	1,192
10	Ujitje kullim	0 4240	23,165
11	Arsimi 9-vjeçar	0 9120	6,928
12	Arsimi i mesëm	0 9230	2,243
	Shuma		148,720

C- TRANSFERTA, FOND SOCIAL, FOND REZERVË,EMERGJENT

Nr.	Art.	Emërtimi	000/Lekë
1	604	Transferim Këshilli Qarkut	300
2	“	Transferte Drej.Tatimeve	50
3	“	Transferte Klubi Futbollit Maliq sha	11,027
4	“	Transfert “Sheqeri” sha Maliq	800
5	606	Fond Social	1,000

6	609	Fond Rezervë	1,000
7	“	Fond Emergjencia Civile	10,100
		Shuma	24,277

D-INVESTIME

Nr.	Art.	Emërtimi	000/Lekë
1	230	Projekte	600
2	231	Ndërtime konstruksione	29,643
3	“	Rrugë	50,826
4	“	Ujësjetlla,KUZ	51,998
5	“	Paisje, Instalime teknike	3,850
6	“	Kafshë për pyllin e fazanëve	400
7	“	Invnetar ekonomik	270
8	“	Mbikqyrje-Kolaudim	3,000
		Shuma	140,587

PASQYRA PËRMBLEDHËSE E SHPENZIMEVE TË BASHKISË

Nr.	Emërtimi i Shpenzimit	Plani 2019 000 lekë	Plani 2020 000/lekë
I	Shpenzime për paga	284.025	293,936
II	Sigurime Shoqërore & Shëndetësore	49.327	50,359
III	Shpenzime Operative	154.060	148,720
	-Mallra dhe Shërbime	143.745	139,531
	-Këshilltarë,K. Fshati	10,315	9,189
IV	Investime	144,161	140,587
V	Transferta të Tjera	15,650	24,277
	-Transferta tek institucione	10,350	12,177
	-Transferta tek individë- Fond Social	2,300	1,000
	-Fond Rezervë	1,000	1,000
	-Fond Mbrojtje Civile	2,000	10,100
VI	Investime në proces (të prapambetura)	88,306	87,157
	TOTALI I-VI	735,529	745,036

E-TË TJERA

1. Kuotë Qarku	0.1 % + DRT (50)	350,000	lekë
2. Fond Rezervë		1,000,000	„
3. Fond për Mbrojtjen Civile		10,100,000	„
4. Fond Social		1.000.000	„
5. Miratim fondi për aktivitete kulturore + honorare viti 2020		2.400,000	„
6. Transferta për Klubin e Futbollit Maliq sha		11,027,000	„

- | | |
|---|---|
| 7. Transferë “Sheqeri“ sha Maliq | 800,000 „ |
| 8. Detyrime viti 2019 | 87.157.000 „ |
| 9. <u>Limiti i shpenzimeve operative për karburant të mjeteve:</u> | |
| a. Benc AA 797 IR | 500 litra gazoil/muaj |
| b. Furgoni AA 861 RI | 200 litra gazoil/muaj |
| c. Mjeti KO 9500 B | 150 litra gazoil/muaj |
| d. Toyota AA 076 TU | 250 litra gazoil/muaj +300 litra/vit për Këshillin e Bashkisë |
| e. Benc AA 424 EA | 150 litra gazoil/muaj |
| f. Gjenerator | 1000 litra gazoil/vit |
| g. Mjeti Benc KO 4648 O | 200 litra gazoil/muaj |
| h. Furgoni AA 540 DL | 150 litra gazoil/muaj |
| i. Ford AA 221 GR | 200 litra gazoil/muaj |
| j. Ford AA 214 GR | 200 litra gazoil/muaj |
| k. Ford AA 213 GR | 200 litra gazoil/muaj |
| l. Kamioni AA 371 PG | 500 litra gazoil/muaj |
| m. Bobcat | 150 litra gazoil/muaj |
| n. Traktor me zinxhira | 400 litra gazoil/muaj |
| o. Borëpastruese | 1,000 litra gazoil/vit; |
| p. Eskavatore | 70.000 litra gazoil për gjithë vitin kalendarik; |
| q. Xhip AA 430 PG | 250 litra gazoil/muaj |
| r. Benzinë për motrçikleta | 800 litra / vit |
| s. Xhipi AA 399 NL | 200 litra gazoil/muaj |
| t. Kaldajën e Shkollës 9-vjeçare Maliq 75 litra/ditë (3 orë) për 4.5 muaj -6000 litra + 2000 litra ne vit kaldaja e shkollës 9-Vjeçare Shqitas= 8000 litra / vit | |
| u. Mjetet Zjarrfikës (2 copë) | 3000 litra për të gjithë vitin kalendarik |
| • AA 071 OO | 1,500 litra/vit |
| • AA 762 VU | 1,500 litra/vit |
| 10. Shpenzime telefonike për titullarin deri 10.000 lekë/muaj por pa kaluar 2% të shpenzimeve operative të aparatit administrativ. | |
| 11. Detyrim për shoqërinë e mbetjeve urbane KRWM | 16,100 mije lekë |
| 12. Kontribut për Shoqatën për Autonominë Vendore | 640 mijë lekë. |
| 13. Shpenzime për Sipërmarrjen e Pastrimit | 26,400 mijë lekë |
| 14. Mirëmbajtje Programi i Tatimeve dhe Financës | 1,320 mijë lekë |
| 15. <u>Shpenzime për Këshillin e Bashkisë dhe Kryetarëve të Fshatrave Viti 2020</u> | |

➤ Anëtarët e Këshillit të Bashkisë

Në buxhetin e vitit 2020 ju kemi propozuar shpërblimin e anëtarëve të Këshillit të Bashkisë në masën 10 % të pagës së Kryetarit të Bashkisë .

Propozimi vjen bazuar në Ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” datë 17.12.2015 neni 51 “Të drejtat e këshilltarëve” pika 1 ku përcaktohet : Këshilltari kryen funksionin me shpërblim mujor të barabartë me 10 për qind të pagës mujore të kryetarit të bashkisë

Shpërblimi nuk ka ndryshime nga një vit më pare, duke u llogaritur dhe propozuar në të njëjtat nivele.

Efekti financiar për këtë zë kap shumën :

31 këshilltarë X 12,500 x 12 muaj = **4,650,000 lekë**

➤ Sekretari i Këshillit të Bashkisë

-Paga e Sekretarit të Këshillit të Bashkisë kap një efekt financiar: 675, 000 lekë

-Sigurimet Shoqërore kapin një efekt financiar 113,000 lekë

➤ Shpenzime Operative 28,000 lekë

- Bojë printer 18,000 lekë

-Letër 10,000 lekë

➤ Trajnim Këshilltarët 200,000 lekë

➤ Shpërblim Kryetarë Fshatrash

-Në Buxhetin e Vitit 2020 ju kemi propozuar një ndarje në % të pagesës së kryetarëve të fshatrave në masën 7 - 10 % të pagës së Kryetarit të Bashkisë apo Administratorëve të Njësive Administrative për fshatrat që mbulojnë.

Me këtë përlllogaritje efekti financiar shkon **4,538,400 lekë**

Propozimi bazohet në VKM nr.165,datë 2.3.2016 “Për grupimin e vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emeruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar pika 16 ku përcaktohet :

Këshillat e njësive të vetëqeverisjes vendore , bazuar në numrin e banorëve të fshatit , miratojnë shpërblimin mujor të kryetarëve të fshatrave, në masën deri 10 % të pagës së: Administratorëve dhe Kryetarit të Bashkisë

Pra propozimi është:

- Mbi 2000 banorë 10 %
- 1000 - 1999 banorë 9 %
- 500 - 999 banorë 8 %
- nën 499 banorë 7 %

Totali i Shpenzimit Këshilltarë + Kryetarë Fshati

Nr.	Emertimi	në lekë
1	Shpërblim Këshilltari	4,650,000
2	Sekretari i Këshillit	788,000
3	Kancelari	28,000
4	Shpërblim Kryetar Fshati	4,538,400
5	Trajnim	200,000
	Shuma	10,204,400

16. Shpenzime për Mbrojtjen Civile

Në lidhje me shpenzimet për Mbrojtjen Civile sqarojmë :

1. Ligji nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile” datë 18.7.2019 në nenin 65 “Buxheti i Bashkive” pika 2 Bashkitë mund të planifikojnë fonde të tjera shtesë nga burimet financiare si më poshtë:
 - a) Nga të ardhurat e veta vendore;

- b) Nga fondet që ju vinë drejtpërdrejtë nga ndarja e taksave dhe tatimeve kombëtare, huamarrja vendore, donacionet;
- c) Si dhe burime të tjera të parashikuara në ligj

Në këtë kuadër në buxhetin e vitit 2020 ne kemi parashikuar nga të ardhurat tona:

- Fond Mbrojtjen Civile 10,100,000 lekë ose 1,7 % të buxhetit total (Trasf.Pak.+BP)

Faleminderit

KRYETARI I BASHKISË

GËZIM TORÇIU

